



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:296891  
Datë: 12.08.2024  
Numri i dokumentit: 06039343

CAP.nr.1484/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, me bashkëpunëtorin profesional Kastriot Makolli, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve të kreditorëve F.R, B.B dhe V.B-Q, të cilët i përfaqëson Labinot Buzuku avokat nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Shtimes, Drejtoria e Arsimit, me objekt të përmbartimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.525/23 të datës 16.06.2023, me datë 12.08.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Komuna e Shtimes, Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.525/23 i datës 16.06.2023, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar E.nr.525/22 i datës 16.06.2023, ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Shtimes – Drejtoria e Arsimit, i ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit E.nr.525/23, të datës 24.03.2023, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj dhe ka lënë në fuqi aktvendimin mbi lejimin e përmbartimit E.nr.522523, i datës 24.03.2023.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor kanë parashtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit ndërsa çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo aktvendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet propozimi për përmbartim.

Përgjigje në ankesë kanë parashtruar kreditorët përmes të autorizuarit të tyre, me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktvendimi ankimuar E.nr.525/22 i datës 16.06.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208, 209 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbare, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me aktvendimin E.nr.525/23 të datës 24.03.2023, gjykata e shkallës së parë ka caktuar përmbaremin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve F.R, B.B dhe V.B-Q, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e kompensimit për licencim dhe shpenzimet e procedurës, në shumë të përgjithshme prej 6,115.60 euro, si dhe shpenzimet e tjera të përmbaremit, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:296891, të datës 14.11.2022, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbaremi deri në përfundim të përmbaremit, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogari bankare.

Kundër këtij urdhri mbi lejimin e përmbaremit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj aktvendimin mbi lejimin e përmbaremit, me arsyetim se Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev.nr.404/22 duke vendosur mbi revizionin e Komunës së Gjilanit – Drejtoria Komonale e Arsimit, ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë, në pjesën e kompensimit të pagës në emër të kualifikimit, dhe ky aktgjykim i Gjykatës Supreme shërben si precedent edhe në rastet tjera të ngjashme.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin me aktvendimin E.nr.525/23 të datës 16.06.2023 ka refuzuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me rastin e nxjerrjes së aktvendimit mbi lejimin e përmbaremit në këtë çështje përmbaremore, janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, për caktimin e përmbaremit të propozuar dhe prapësimi i përfaqësuesit të debitorit është në tërësi i pabazuar. Më tej, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të debitorit në prapësim se Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e Rev.nr.404/2022, duke vendosur mbi revizionin e Komunës së Gjilanit, Drejtoria e Arsimit, ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë, në pjesën e kompensimit të pagesë në emër të gradimit apo të kualifikimit. Ky aktgjykim shërben si precedent edhe raste tjera të ngjashme, gjykata këtë pretendim e konsideron të pa bazuar për arsye se gjykata nuk mund të merr për bazë aktgjykimin e cekur të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, sepse ky aktgjykim siç shihet është nxjerrë për çështje tjetër juridike kontestimore dhe nuk ka të bëjë fare me pajtimin gjyqësor në rastin konkret dhe përderisa në rastin konkret nuk kemi ndonjë aktgjykim të nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë por edhe nga gjykata e shkallës së dytë për pajtimin gjyqësor 2021:296891, të datës 14.11.2022,

për Gjykatën Themelore në Ferizaj pajtimi gjyqësor i cekur më lart ende konsiderohet dokument përmbartimor i paraparë në nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e 22, 27, dhe 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK, dhe se drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për refuzim të prapësimit të debitorit dhe lënien në fuqi të aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit E.nr.522/23, të datës 22.03.2023, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se Pajtimi Gjyqësor i lidhur në Gjykatën Themelore në Ferizaj me numër 2021:296891 i datës 14.11.2022 dhe i ekzekutueshëm nga data 31.12.2022, në rastin konkret është dokument përmbartues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton së: “*dokument përmbartimor është vendimi përmbartues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbartuese*” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: “*dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit*”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e refuzimit prapësimit nuk qëndrojnë.

Pretendimet e debitorit për vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përmbartimore Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke iu përmbartur parimit të rigorozitetit formal-juridik, që nënkupton se Gjykata do të vlerësojë shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera që i përkasin procedurës në të cilën është nxjerr dokumenti përmbartimor.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit por të cilat nuk kanë qenë me rëndësi vendimtare për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë dhe se për këtë arsye gjykata ankimore ka vendosur që t’i refuzojë ndërsa aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1484/2023, me datë 12.08.2024

Gjyqtarja,  
Frosina Sylejmani